



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission



Prishtinë/Priština, rr./ul. Migjeni p.n/b.b; tel. +381 (0) 38 211 337; kqz.sekretariati@kqz-ks.org; www.kqz-ks.org

Komunikatë

11.07.2013

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, mbajti mbledhjen e 32-të të kryesuar nga kryetarja, znj. Valdete Daka. Në këtë mbledhje, si pikë e veçantë ishte caktimi i emrave për anëtar të Grupit Punues për draftimin e Marrëveshjes së Bashkëpunimit me OSBE-në.

Anëtarët e KQZ-së, diskutuan propozimin lidhur me formimin e grupit. Alban Krasniqi, kërkoi që për këtë çështje të ketë vendim me shkrim. Krasniqi, kërkoi nga anëtarët e KQZ-së që të mos bëhen pjesë e këtij grupi, si dhe kritikoi edhe OSBE-në. Z. Krasniqi, kundërshtoi mbledhjet e mbyllura, si dhe tha se kjo nuk është marrëveshje me elemente ndërkombëtare. Ilir Gashi, rikujtoi vendimin e mbledhjes paraprake ku është marrë vendimi për themelimin e këtij grupi, dhe tha se në përputhje me këtë vendim, sigurisht që do të jenë anëtarët e grupit. Me pajtimin edhe të anëtarëve të KQZ-së, z. Ilir Gashi, kërkoi të jetë anëtar i grupit. Fadil Maloku, e cilësoi mënyrën e procedimit si “vendim, mbi vendim”! Kurse Florian Dushi, tha se, emrat duhet të jenë në vendim. Marrëveshja, do të vijë në KQZ dhe nisur nga qëndrimi ynë publik, marrëveshja nuk duhet në asnjë rast t’i cenoj autorizimet kushtetuese që ka KQZ.

Në fund të mbledhjes, me tetë (8) vota për dhe një (1) votë kundër, KQZ vendosi që së bashku me OSBE-në, ta hartojë Draft marrëveshjen e bashkëpunimit. U caktuan edhe anëtarët e Grupit Punues: Valdete Daka, Ilir Gashi, Florian Dushi, Binak Vishaj dhe Goran Zdravković.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
